



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 4 maj 2016
Nr. ref.: RK932/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI27/15

Parashtrues

Naser Peci

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, KRJ. nr. 1/2015, të 21 janarit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Naser Peci, avokat nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, KRJ. nr. 1/2015, të 21 janarit 2015, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, A. A. nr. 321/2014, të 7 nëntorit 2014, dhe me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, A. nr. 746/2011, të 11 qershorit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, KRJ. nr. 1/2015, të 21 janarit 2015, për të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i ka cenuar atij të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 10 mars 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 21 prill 2015, Kryetari i Gjykatës, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy, Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 26 qershor 2015, ka përfunduar mandati i gjyqtarit Kadri Kryeziu. Më 1 korrik 2015, Kryetarja e Gjykatës, caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues në vend të gjyqtarit Kadri Kryeziu.
8. Më 30 shtator 2015, parashtruesi u njoftua për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
9. Më 14 mars 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 23 shkurt 2011, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (në tekstin e mëtejme: KGJK), kishte shpallur konkurs për vende të lira pune për gjyqtar në disa komuna të Republikës së Kosovës.
11. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi kishte konkurruar për pozitë të gjyqtarit.

12. Më 13 qershor 2011, KGJK-ja njoftoi parashtruesin e kërkesës se ai nuk mund të jetë pjesë e procesit për t'u zgjedhur gjyqtar, për shkak se ai nuk kishte vijuar dhe përfunduar me sukses Programin Fillestar të Arsimimit Ligjor (në tekstin e mëtejshëm: PFAL). Parashtruesi, po ashtu, u njoftua se ai mund të sjellë informacion mbështetës deri më 17 qershor 2011, për të provuar se ai e plotëson kriterin në fjalë.
13. Më 15 qershor 2011, parashtruesi i kërkesës iu drejtua KGJK-së, duke pretenduar, ndër të tjera, se ai meriton që kërkesa e tij të shqyrtohet në themelësi dhe jo të refuzohet, për shkak të mos vijimit dhe përfundimit me sukses të PFAL. Parashtruesi, po ashtu, pretendoi se ai kishte përvojë pune 30 vjeçare dhe se nuk kishte nevojë të vijonte PFAL.
14. Më 22 qershor 2011, KGJK-ja njoftoi parashtruesin e kërkesës se vijimi dhe përfundimi me sukses i PFAL ishte kriter ligjor dhe se për shkak të mos plotësimit të këtij kriteri, ai nuk mund të konsiderohej kandidat i mundshëm në procesin e përzgjedhjes së gjyqtarëve.
15. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës filloi konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër njoftimeve të KGJK-së, të 13 dhe 22 qershorit 2011.
16. Më 11 qershor 2014, Gjykata Themelore me Aktgjykimin, A. nr. 746/2011 refuzoi, të pabazuar, kërkesëpadinë e parashtruesit të paraqitur kundër njoftimeve të KGJK-së.
17. Pjesa relevante e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, përcakton:

“Me dt. 22. 06. 2011, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, i përgjigjet të njëjtit, duke e njoftuar se KGJK-së me dt. 23. 02.2011, shpall konkurs publik për pozita gjyqësore dhe kriteret për këto pozita kanë qenë të bazuara në rregulloret e UNMIK-ut në fuqi dhe Rregullores mbi Procesin e Emërimit të Gjyqtarëve. Neni 5 i Rregullores mbi Procesin e Emërimit të Gjyqtarëve, kërkon që kandidatët duhet të kenë vijuar dhe përfunduar me sukses këtë program, në mënyrë që të trajtohen si kandidat potencial. Prandaj, në mungesë të këtij kriteri, në bazë të nenit 2.3 dhe nenit 5 të Rregullores mbi Procesin e Emërimit të Gjyqtarëve, ju nuk mund të trajtoheni në këtë proces, si kandidat potencial, për pozita gjyqësore.

Po ashtu, gjykata iu referua edhe Rregullores së Këshillit Gjyqësor të Kosovës, mbi Procesin e Emërimit të Gjyqtarëve, nenit 5.1 të të njëjtës, i cili përcakton se " KGJK-së në bashkëpunim me IGJK-në, për pozita gjyqësore do të organizoj provim pranues, për Programin Fillestar të Arsimimit Ligjor. Kandidatët që nuk e kalojnë provimin pranues, apo nuk kalojnë me sukses Programin Fillestar të Arsimimit Ligjor, nuk do të merren për shqyrtim të mëtejshëm për emërim”.
18. Më 11 korrik 2014, parashtruesi i kërkesës u ankua në Gjykatën e Apelit të Kosovës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje të dispozitave të ligjit për konflikt administrativ. Parashtruesi pretendoi se “Gjykata Themelore kishte për obligim që ta detyronte të paditurin (KGJK-në)

që të nxjerrë vendim në rastin e tij dhe jo të vendosë për themelësinë e padisë së tij (duke e refuzuar atë) dhe se atij i ishte cenuar e drejta për t'u emëruar gjyqtar bazuar në një rregullore që është në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin”.

19. Më 7 nëntor 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktgjykimin, A. A. nr. 321/2014, refuzoi të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit miratoi në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, duke konstatuar se aktgjykimi i kontestuar është i bazuar në ligj dhe prova, dhe se vijimi dhe përfundimi i PFAL është kriter i paraparë me ligj, që duhet plotësuar nga të gjithë kandidatët që konkurrojnë për t'u zgjedhur gjyqtar në gjykatat e Republikës së Kosovës.
20. Më 2 dhjetor 2014, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje të dispozitave të ligjit procedural dhe të dispozitave materiale. Parashtruesi, po ashtu, propozoi anulim të vendimit të Gjykatës së Apelit dhe që çështja të kthehet për rivendosje. Parashtruesi, ndër të tjera, përsëriti pretendimet e tij, se gjykatat e instancës më të ulët kishin obligim që ta detyronin të paditurin (KGJK-në), që të nxjerrë vendim në rastin e tij dhe se njoftimet e KGJK-së në të vërtetë ishin heshtje administrative dhe jo akte apo vendime administrative.
21. Më 21 janar 2015, Gjykata Supreme me Aktgjykimin KRJ. nr. 1/2015, refuzoi të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paraqitur nga parashtruesi kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Gjykata Supreme miratoi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit përkitazi me vërtetimin e gjendjes faktike, zbatimin e dispozitave procedurale dhe materiale të ligjit administrativ dhe kriterin ligjor që duhet plotësuar për t'u konsideruar kandidat për gjyqtar në Republikën e Kosovës.
22. Pjesa relevante e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme përcakton:

“Në pajtim me dispozitën e lartpërmendur të nenit 6 të Rregullores për procedurën e emërimit të gjyqtarëve, Gjykata Supreme konsideron se gjykatat e shkallës më të ulët në mënyrë të drejtë kanë vepruar me rastin e refuzimit si të pabazuar të kërkesëpadisë së paditësit për shkak të mos nxjerrjes së vendimit nga ana e organit administrativ të shkallës së dytë, heshtjes administrative. Në të vërtetë, Gjykata Supreme gjen se vendimi - lajmërimi i Panelit për vlerësim, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës ZVVGJP/11/dr/163, të datës 13.06.2011, me të cilin paditësi është informuar se sipas nenit 6.2 të Rregullores për procedurën e emërimit, nuk i plotëson kushtet për t'u zgjedhur gjyqtar, duke marrë parasysh se nuk ka vijuar dhe kryer me sukses programin fillestar për arsimim ligjor, konsiderohet si vendim i organit administrativ të shkallës së parë, kurse vendimi-lajmërimi ZVVGJP/11/dr/240, i datës 22.06.2011 i Panelit për vlerësim, i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, i nxjerrë në bazë të kundërshtimit të paditësit, konsiderohet si vendim administrativ i organit të shkallës së dytë kundër të cilit mund të udhëhiqet konflikt administrativ. Nga të lartpërmendurat, kjo Gjykatë konsideron se në këtë çështje administrative nuk mund të bëhet fjalë për mos nxjerrje të vendimit nga organi i shkallës

së dytë, heshtje e administratës, për shkak të cilës gjykatat e shkallës më të ulët me të drejtë kanë vepruar kur kanë refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi pretendon se është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, garantuar me nenin 31 të Kushtetutës.
24. Parashtruesi thekson se *“përmbajtja e vendimeve të gjykatave të rregullta i referohet vetëm aspektit ligjor por jo edhe atij material. Asnjë nga vendimet e gjykatave vendore nuk ka trajtuar në përmbajtje faktin se a i ka plotësuar kushtet për konkurrim parashtruesi i kërkesës sipas ligjit dhe kushtetutës apo nuk i ka plotësuar”.*
25. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që *“të vërtetohet se është shkelur e drejta në gjykim të drejtë dhe se eliminimi nga gara për gjykatës ka qenë në kundërshtim me Kushtetutën dhe Ligjin”.*

Pranueshmëria e kërkesës

26. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
28. Gjykata, po ashtu, i referohet nenit 48 të Ligjit, që përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.
29. Gjykata, më tej, merr parasysh rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

...

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.
30. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që *“të vërtetohet se është shkelur e drejta në gjykim të drejtë dhe se eliminimi nga gara për gjykatës ka qenë në kundërshtim me Kushtetutën dhe Ligjin”.*

31. Gjkata konsideron se gjykatat e rregullta kanë dhënë arsye të mjaftueshme e bindëse në mbështetje të përfundimeve të tyre sepse kanë shpjeguar: (i) çështjen e kriterëve ligjore që duhen plotësuar nga kandidatët që konkurrojnë për t'u zgjedhur gjyqtarë, (ii) mandatin kushtetues dhe ligjor të KGJK-së përkitazi me propozimin e kandidatëve për emërim në pozita gjyqësore, (iii) natyrën detyruese të kriterit për arsimim ligjor (PFAL) pavarësisht nga përvoja e kandidatëve dhe (iv) kanë vlerësuar se njoftimet e KGJK-së janë vendime administrative dhe jo heshtje administrative siç kishte pretenduar parashtruesi i kërkesës.
32. Gjkata thekson se, sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj të veprojë si “*gjykatë e shkallës së katërt*” në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Rrjedhimisht, Gjkata nuk merret me gabimet në konstatimin e faktit apo interpretimin e ligjit (ligjshmërinë), që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). (Shih rastin *Akdivar kundër Turqisë*, Nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, po ashtu, *mutatis mutandis*, në Rastin nr. KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).
33. Gjkata vëren se pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës ngrenë çështje të ligjshmërisë dhe të fakteve dhe jo të kushtetutshmërisë.
34. Gjkata, po ashtu, vëren se parashtruesi i kërkesës vetëm sa e përmend dispozitën kushtetuese që garanton gjykim të drejtë dhe të paanshëm, pa shpjeguar saktësisht dhe mbështetur me prova konkrete pretendimin e tij se është viktimë e cenimit të kësaj të drejte. Për më tepër, kërkesa nuk tregon në mënyrë të argumentuar që gjykatat e rregullta të Republikës së Kosovës kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë, përkatësisht në shpërputhje me standardet e garantuara kushtetuese.
35. Fakti që parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e procedurave të zhvilluara nga gjykatat e rregullta, nuk përbën themel për të ndërtuar kërkesë të argumentuar për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], të garantuar me Kushtetutë (Shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).
36. Si përfundim, Gjkata vlerëson se faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk arsyetojnë pretendimin për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë.
37. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të shpallet e papranueshme, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, më 14 mars 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Bekim Sejdiu

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi